

Bilanci i energjisë elektrike

Tremujori II - 2022


Tiranë, më 31 Gusht 2022: Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, energjia elektrike në dispozicion u ul me 3,5 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike në këtë periudhë u ul me 38,1 % duke arritur vlerën 1.647 GWh nga 2.660 GWh energji të prodhuar në tremujorin e dytë të vitit 2021.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 38,3 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 60,9 % dhe nga të tjerë prodhues (Fotovoltaik) në masën 0,8 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje), në tremujorin e dytë të vitit 2022, arriti vlerën 664 GWh nga 228 GWh që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar kështu një rritje me 2,9 herë. Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 415 GWh nga 924 GWh duke shënuar një rënie me 55,1 % (tab.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Për publikim 31/08/2022

Tab. 1 Bilanci i energjisë elektrike

Treguesit		Tr. II 2021	Tr. II 2022
		MWh	
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	1.963.921	1.895.695
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	2.659.642	1.646.982
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hydrocentrale (1.2=a+b)	2.646.536	1.633.353
a	Publike (a=a.1-a.2)	1.556.770	631.006
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	1.570.399	637.449
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	13.629	6.443
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	1.089.766	1.002.347
1.3	Të tjerë prodhues (Fotovoltaik)	13.106	13.629
2	Importi bruto (energji në marrje)	228.239	663.815
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	923.960	415.102
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	1.963.921	1.895.695
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	400.441	362.521
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	60.694	55.673
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	339.747	306.848
a	Humbjet teknike në shpërndarje	222.494	208.619
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	117.253	98.229
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.563.480	1.533.174
2.1	Familjarë	697.801	685.610
2.2	Jo Familjarë	865.679	847.564

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.


² Humbjet jo teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Hidrocentralet publike, në tremujorin e dytë të vitit 2022, prodhuan 631 GWh nga 1.557 GWh të prodhuar në tremujorin e dytë të vitit 2021, duke shënuar kështu një rënie të prodhimit me 59,5 %.

Hidrocentralet private dhe koncensionare, prodhuan 1.002 GWh nga 1.090 GWh të prodhuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 8,0 %.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në tremujorin e dytë të vitit 2022 ka arritur vlerën negative prej 249 GWh krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2021 ku kishte një vlerë pozitive prej 696 GWh.

Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike




Humbjet në rrjet arritën vlerën 363 GWh nga 400 GWh duke shënuar kështu një rënie me 9,5 %.

Humbjet në transmetim kanë rënë me 8,3 % ndërsa **humbjet në shpërndarje** kanë rënë me 9,7 %.

Humbjet teknike në shpërndarje kanë shënuar një rënie me 6,2 %, ndërsa **humbjet jo teknike në shpërndarje** kanë shënuar një rënie me 16,2 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2021 (fig.3).


Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e dytë të vitit 2022, u ul me 1,9 % duke arritur vlerën 1.533 GWh nga 1.563 GWh që ishte në tremujorin e dytë të vitit 2021.

Ndikimin më të madh në uljen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët e kanë dhënë **konsumatorët jo familjarë**, ku kemi një rënie të konsumit të energjisë elektrike me 2,1 %, përkundrejt rënies me 1,7 % të energjisë së konsumuar nga **konsumatorët familjarë** (fig. 4).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët familjarë.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshirë konsumin nga familjarët.

Në llogaritjen e këtij treguesi përfshihet edhe *dëmi ekonomik* i llogaritur për konsumatorët jo familjarë.